

## SYLLABUS I LËNDËS SHKRIM AKADEMIK

Të dhëna bazike të lëndës			
<b>Fakulteti/Departamenti</b>	Fakulteti i Filologjisë/Gjuhë dhe Letërsi Shqipe		
<b>Titulli i lëndës</b>	<b>Shkrim akademik</b>		
<b>Programi</b>	<b>Gjuhë dhe Letërsi Shqipe</b>		
<b>Niveli</b>	Bachelor		
<b>Statusi i lëndës</b>	Obligative		
<b>Viti i studimeve</b>	Viti II, semestri IV		
<b>Numri i orëve në javë</b>	2+1		
<b>Vlera në KREDI-ECTS</b>	5		
<b>Koha/lokacioni</b>	Semestri veror		
<b>Mësimdhënësi i lëndës</b>	<b>Prof. asoc. dr. Flamur Shala</b>		
<b>Detajat kontaktuese</b>	<a href="mailto:flamur.shala@uni-prizren.com">flamur.shala@uni-prizren.com</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Shkrimi akademik është një nga lëndët e cila ka lidhje të ngushtë me <i>degët e tjera të gjuhësisë</i> dhe se mësimi i kësaj lënde ka të bëjë me teknikat e shkrimit të tekstit, paragrafit, fjalisë. Ka të bëjë me koherencën midis njësive dhe pjesëve të tekstit, fjalisë dhe paragrafëve, ka të bëjë me organizimin e tekstit.		
<b>Qëllimi i lëndës</b>	<p>Qëllimi i lëndës është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Të ngrejë nivelin e përgjithshëm mbi përdorimin e gjuhës.</li> <li>-Të identifikojë konceptet dhe teoritë nga fusha e shkrimit akademik.</li> <li>-Të zhvillojë aftësitë e komunikimit dhe transmetimit të dijes së tyre.</li> <li>-Të zhvillojnë aftësitë për të gjykuar, krahasuar, analizuar, sintetizuar etj.</li> </ul>		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studenti:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shpjegon rregullat për një shkrim dhe komunikim efikas në gjuhën shqipe;</li> <li>2. Kupton se <i>Shkrimi akademik</i> është lëndë e pandashme nga degët kryesore të gjuhësisë, stilistikës së gjuhës;</li> <li>3. Kupton se shkrimi i një teksti nënkupton një dije të mirëfilltë paraprake mbi gjuhën, sistemin dhe përdorimin e saj.</li> <li>4. Vlerëson rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të gjuhës në konsolidimin dhe zhvillimin e shoqërisë;</li> <li>5. Zhvillon shkathtësitë e komunikimit, me anë të të shkruarit;</li> <li>6. Shkruan dhe zhvillon punime seminarike.</li> <li>7. Kupton prirjet e përgjithshme të zhvillimit të teknikave të shkrimit;</li> </ol>		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitja e punimit të seminarit	1	15	15
Detyra –analizë gjuhësore	1	15	15
Parapërgatitja për testin e parë (gjysmësemestral)	1	5	5
Konsultime	1	15	15
Parapërgatitja për testin (provimi) përfundimtar	1	10	10
<b>Ngarkesa totale</b>			<b>125 orë (5 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime, seminare, prezantime, bashkëbisedim, konkretizim.		
	<p>Seminari, testi gjysmësemestral, prezantimi, testi përfundimtar.</p> <p>Testi gjysmësemestral ka -25 pikë Të gjitha aktivitetet -20 pikë</p>		

<b>Metodologjia e vlerësimit</b>	(vijueshmëria, seminar, prezantime, detyra) Testi përfundimtar -55 pikë Total: 100 pikë  Vlerësimi me pikë 01-49=5, 50-60 =6, 61-70=7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10	
<b>Literatura</b>		
<b>Literatura primare:</b>	Vehbi Miftari, <i>Shkrimi akademik</i> , Prishtinë, 2013, 2019. Gjovalin Shkurtaç, <i>Si të shkruajmë shqip</i> , Tiranë, 2017. Sylvian Barnet-Pat Ballanca-Marika Stubbs, <i>Shkrimi akademik</i> , Dita, Tiranë, 2000. Bardhyl Musai, <i>Si të shkruajmë ese</i> , QAD, Tiranë, 2004. Majlinda Nishku, <i>Procesi dhe shkrimet funksionale</i> , QAD, Tiranë, 2004.	
<b>Literatura shtesë:</b>	Umberto Eko, <i>Si bëhet një punim diplome</i> . Përktheu dr. Kristina Jorgaqi, Botime “Përpjekja”, Tiranë, 1997. <i>Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe</i> , Prishtinë 1974. Grup autorësh, <i>Gramatika e gjuhës shqipe I, II</i> , Tiranë, 2002.	
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Lënda e shkrimit akademik -Nocione të përgjithshme	Të shkruarit e një teksti – Analiza e structures
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në teknikën e shkrimit, Teksti dhe komunikimi, strategjitë e tekstit, funksionet e tekstit, aftësitë e tekstit, organizimi i tekstit	Strategjia e leximit Mbarështrimi i ligjëratës retorike Natyra e shkrimit Lidhja logjike
<i>Java e tretë:</i>	Teknikat themelore të shkrimit -Analizimi, Kërkimi, Plani i përgjithshëm, Shkrimi, Redaktimi (rishikimi)	Përzgjedhja e temës, burimet, klasifikimi i informatave, elementet relevante dhe jorelevante të tekstit
<i>Java e katërt:</i>	Analizimi/përzgjedhja e temës -Përcaktimi për tezën themelore -Treguesi i lëndës	Përcaktimi i tezës themelore Dhe treguesi i lëndës -Teksti i shkruar
<i>Java e pestë:</i>	Kërkimi/mbledhja e materialit -Kërkimi burimeve -Llojet e burimeve -Referimet e brendshme -Bibliografia	Burimet parësore dhe dytësore Referimet e brendshme dhe bibliografia. -Teksti i shkruar
<i>Java e gjashtë:</i>	Plani i përgjithshëm -Grupimi dhe kategorizimi i informatave -Strukturë koherente, logjike dhe transparente -Përfshirja elementeve mbështetëse për tezën -Përcaktimi i rendit të parashtrimit -Largimi i gjërave jorelevante	Plani i përgjithshëm -Klasifikimi i informatave dhe përzgjedhja e tyre për aktin e shkrimit. -Teksti i shkruar
<i>Java e shtatë:</i>	Të shkruarit e tekstit	Të shkruarit e tekstit

	-Sfondi (koha dhe hapësira) -Veta, Pikëshikimi, Ligjërimi/diskursi, Ligjëratë e drejtë/ligjëratë e zhdrejtë, stili dhe diskursi, përdorimi i gjuhës, Uniteti, koherenca dhe kohezioni	Stili dhe diskursi Koherenca dhe kohezioni -Teksti i shkruar
<i>Java e tetë:</i>	Test	-Teksti i shkruar
<i>Java e nëntë:</i>	Rishikimi i tekstit Metoda, përmbajtja, interesi, qartësia, përpikëria, redaktimi autorial	Rishikimi i tekstit Redaktimi autorial
<i>Java e dhjetë:</i>	Teknikat e shkrimit/struktura e tekstit Struktura e paragrafit -Llojet e paragrafëve (sipas karakterit): Paragrafi përshkruar, Paragrafi shpjegues, Paragrafi retorik-bindës	Struktura e tekstit dhe e paragrafit Llojet e paragrafëve -Teksti i shkruar
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Llojet e paragrafëve (sipas funksionit) -Paragrafi hyrës -Paragrafi shtjellues -Paragrafi përmbyllës	Paragrafët sipas funksionit -Teksti i shkruar
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Struktura e tekstit -Titulli, hyrja, trupi, përmbyllja	Struktura e tekstit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Struktura gjuhësore e tekstit -Struktura e fjalisë-Fjalitë e thjeshtë -Llojet e fjalisë sipas qëllimit -Fjalitë dëftore -Fjalitë pyetëse -Fjalitë dëshirore -Fjalitë nxitëse -Llojet e fjalisë sipa strukturës	Struktura e tekstit dhe llojet e fjalisë sipas qëllimit
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Mënyrat e adresimit -Arti i të shkruarit të një letre -Teknikat e të shkruarit të një letre Format kryesore të adresimit -Kërkesa -Përgjigjja	Adresimi Shkrimi i një letre
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Format kryesore të adresimit -Pranimi -Memorandumi -Aplikimi për punë -Aplikimi (letra e motivimit) -Biografia, komunikimi elektronik	Shkrimi i një kërkesë, përgjigjeje, vërejtjes, kërkimfaljes dhe urimit
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>		
Studenti duhet të respektojë rregullat e institucionit: - Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;		

- Të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e Kartelës studentore (ID-së) në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.